



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.11.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **PRO MEDICAL SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me paisje për laboratore të shkollave “ , **Nr. i prokurimit-632-22-11151-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-124-121, nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **PRO MEDICAL SH.P.K.** e dt.23.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me paisje për laboratore të shkollave “ , **Nr. i prokurimit- 632-22-11151-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-124-121**, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 23.08.2022, në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë 23.08.2022.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos q vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik **PRO MEDICAL SH.P.K.**, me dt.23.11.2022, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje për laboratore të shkollave", Nr. i prokurimit- 632-22-11151-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-124-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka licencë nga AKPM, është i pabazuar, sepse kjo licencë nuk ka qenë kërkesë e Autoritetit kontraktues në FDT-ë. Nëse një kriter nuk është kërkuar nga Autoriteti kontraktues në FDT-ë, nuk mund t'i kërkohej një operatori ekonomik e as të eliminoj për këtë shkak.

Ju si operatorë ekonomik është dashur të bëni kërkesë për rishqyrtim para hapjes së tenderit lidhur me këtë kriter.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

